



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Mars 2021

Nr: 127

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA  
PARTIA “NISMA THURJE” PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL  
2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

Partia “Nisma Thurje” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Partia “Nisma Thurje” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore për 12 zona zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Partisë “Nisma Thurje” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Dibër**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
2. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8, zj. Melisa Pirra **Qarku Dibër**, pika 7 dhe 8 rezultojnë të jenë të paplotësuara;



3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor duke tejkualuar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
4. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 9, z. Artur Veliaj **Qarku Durrës**, rezulton që pika 8 është e paplotësuar por janë specifikuar të dhëna;
5. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 4, zj. Besjana Rama **Qarku Fier**, rezulton që në rubrikën “A” nuk është shkruajtur nr. ID;
6. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 7, zj. Boriانا Durmishi **Qarku Fier**, rezulton që në rubrikën “A” nuk është shkruajtur nr. ID;
7. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8, z. Renuar Kodra **Qarku Fier**, në rubrikën II rezulton që nuk ka shkruajtur emër, mbiemër;
8. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkualuar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
9. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 16, zj. Ada Backa **Qarku Elbasan**, rezulton që në rubrikën “A” nuk është vendosur nr ID;
10. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkualuar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
11. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Kukës** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkualuar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
12. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Shkodër** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkualuar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
13. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkualuar numrin e kërkuar me 6 kandidatë;
14. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 12, zj. Brunilda Dhrami, **Qarku Tiranë**, rezulton që pika 8 është e paplotësuar por janë specifikuar të dhëna;
15. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 35, z. Ardian Sulollari **Qarku Tiranë**, rezulton të ketë paqartësi për shkak se ka depozituar faqen 4 dy herë, duke deklaruar në pikën 5, njëherë “PO” dhe nuk ka dhënë specifikime të të dhënave dhe njëherë ka deklaruar “JO”;



16. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
17. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 06, zj. Anduela Ismaili **Qarku Vlorë**, rezulton që në rubrikën “A” nuk ka vendosur nr ID.

Në bazë të nenit 73 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim subjektit zgjedhor, Partia “Nisma Thurje”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

#### **V E N D O S :**

1. Kthimin për korrigjim sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë “Nisma Thurje”, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

